

VENDIM
Nr.169, datë 30.3.2004

**PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.582, DATË 21.8.2003 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR MIRATIMIN E METODOLOGJISË SË RREGULLIMIT TË
TARIFAVE TË ORGANIZMAVE ME FUQI TË NDJESHME NË TREG, QË OFROJNË
SHËRBIME PUBLIKE TELEFONIKE TË QËNDRUESHME DHE LINJA ME QIRA”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 62 të ligjit nr.8618, datë 14.6.2000 “Për telekomunikacionet në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e Ministrit të Transportit dhe të Telekomunikacionit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në dokumentin “Metodologjia e rregullimit të tarifave të operatorëve publikë të telekomunikacioneve, që ofrojnë shërbime publike, telefonike të qëndrueshme dhe linja me qira”, të miratuara me vendimin nr.582, datë 21.8.2003 të Këshillit të Ministrave, të bëhen këto ndryshime:

a. Pika 2 ndryshohet si më poshtë vijon:

“2. Ndryshimi i tarifave bëhet një herë në vit. Tarifat e llogaritura sipas pikës 1 propozohen nga operatori, pas pranimit të bilancit financiar vjetor nga dega e tatim-taksave, të shoqëruara me të dhënat dhe analizën e hollësishme për llogaritjen e kostos dhe të tarifës mesatare, për çdo zë shërbimi. Zbatimi i tarifave të reja, të verifikuara nga ERT-ja, mund të bëhet me faza për të zbutur reagimin e tregut dhe për të ulur, deri në nivelin e pranuar, subvencionet ndërmjet shërbimeve.”.

b. Pikat 5 dhe 6 shfuqizohen.

c. Pika 7 ndryshohet si më poshtë vijon:

“7. Tarifat e shërbimeve të grupit “Komunikime telefonike automatike” të zbatohen në lekë për kohë komunikimi ose nëpërmjet kombinimit të numrit të impulseve të tarifimit me çmimin e impulsit.”.

ç. Pika 8 ndryshohet si më poshtë vijon:

“8. Në zërat e shërbimeve të grupit “Komunikime telefonike automatike”, operatori mund të zbatojë tarifa fillestare me fillimin e komunikimit (Start up fee).”.

d. Shkronja “b” e pikës 10 shfuqizohet.

2. Ngarkohet Enti Rregullator i Telekomunikacioneve për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano